

Lista e institucioneve publike, 2018

Tiranë, më 13 Shtator 2019: INSTAT, ofron për përdoruesin listën e institucioneve publike që janë pjesë e sektorit të Qeverisë së Përgjithshme si dhe korporatat Financiare dhe Jo-financiare që janë në pronësi të entiteteve publike për vitin 2018.

[Lista e institucioneve publike, pjesë e sektorit publik \(link\)](#)

Njësitë shpenzuese buxhetore të Sektorit publik përbëhen nga nën-sektori i Qeverisë Qëndrore (S.1311) me 919 njësi shpenzuese buxhetore, nën-sektori i Qeverisë Lokale (S.1313) me 184 njësi shpenzuese buxhetore dhe nën-sektori Fondet e Sigurimeve (S.1314) me 2 njësi shpenzuese.

Ndryshimi i numrit të njësive shpenzuese buxhetore vjen si rrjedhojë e ndryshimeve strukturore të Qeverisjes Qëndrore, riklasifikimeve, si dhe njësive të reja apo të mbyllura.

Tab. 1 Sektori Publik në Shqipëri, Viti 2018

	Nën-sektorët	2018
Qeveria Qëndrore	S.1311	985
Buxhetore ¹	919	919
Extra-Buxhetore	66	66
Qeveria Federale²	S.1312	-
Qeveria Lokale	S.1313	270
Buxhetore	184	184
Extra-Buxhetore	86	86
Fondet e Sigurimeve	S.1314	2
Korporatat Publike Jo-financiare	S.11001	16
Korporatat Publike Financiare	S.12701	1
Banka Qëndrore	S.121	1
Totali i Njësive Shpenzuese		1.275

Njësitë extra-buxhetore të Sektorit publik përbëhen nga nën-sektori i Qeverisë Qëndrore (S.1311) me 66 njësi shpenzuese dhe nën-sektori i Qeverisë Lokale (S.1313) me 86 njësi shpenzuese.

Përveç institucioneve buxhetore dhe extra-buxhetore, sektori publik, përfshin edhe nën-sektorin e Korporatave Publike Jo-financiare (S.11) me 16 njësi, nën-sektorin e Korporatave Publike Financiare (S.12) me 1 njësi dhe nën-sektorin e Bankës Qëndrore (S.121) me 1 njësi.

¹ Numri i njësive buxhetore përfshin njësitë shpenzuese të raportuara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë, në Ministrinë e Financave dhe e Ekonomisë, gjatë vitit 2018.

² S.1312 - Qeveria Federale, ky nën-sektor nuk aplikohet në Shqipëri.

Për publikim 13/09/2019